

SUREP: KOMPONENTA E RIINTEGRIMIT EKONOMIK TË PERSONAVE TË RIATDHESUAR DHE FAMILJEVE TË TYRE

27 prill 2020

◆ Projekti SUREP

Projekti "Kthimi i Qëndrueshëm i Personave të Riatdhesuar përmes Riintegritimit Socio-Ekonomik (SUREP)" realizohet nga Caritasi Zviceran (CaCH) së bashku me dy organizatat partnere: Agjensioni i Përkrahjes së Punësimit Kosovë (APPK) dhe Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës (QKRMT). Përmes projektit SUREP synojmë mbështetjen e individëve të cenueshëm dhe familjeve të tyre të riatdhesuar nga Evropa Perëndimore në Kosovë.

◆ Riintegrimi Ekonomik

Komponenta e riintegritimit ekonomik ka për qëllim riintegrimin e qëndrueshëm ekonomik të individëve të cenueshëm dhe familjeve të tyre të riatdhesuar nga Evropa Perëndimore në Kosovë përmes masave aktive të punësimit:

Trajnimi në punë

Trajnimi në punë i ngrit shkathtësitë praktike të kandidatëve në një vend të caktuar pune. Kjo rrit mundësitë që kandidatët të kenë një vend-pune të qëndrueshëm dhe afatgjatë pas përfundimit të trajnimit.

Trajnim për themelimit biznesi dhe vetëpunësim

Në këtë trajnim, kandidatët fitojnë shkathtësi të nevojshme për të udhëhequr biznesin e tyre. Me ide të reja biznesi, ata kanë mundësi të aplikojnë për një grant për të filluar biznesin e tyre.

Referimi për trajnim profesional

Në rastin kur kandidatët kanë nevojë apo shfaqin interes për trajnim profesional, ata referohen për të vijuar trajnimin në një nga Qendrat e Aftësisimit Profesional të regjionit përkatës.


Statistika për kandidatët përfitues nga masa e Trajnimit në Punë

Në kuadër të projektit SUREP, në masën e Trajnimit në Punë kanë përfituar gjithsejtë tetë (8) persona të riadhesuar. Trajnimi në punë ka pasur për qëllim ngritjen e shkathtësive praktike të kandidatëve në një vend të caktuar pune, me qëllimin që kandidatët të krijojnë një vend të qëndrueshëm pune pas trajnimit.

Statistika




Mosha e kandidatëve pjesëmarrës në trajnim



◆ Moshë

Nga 8 kandidatë, të cilët kanë ndjekur Trajnimin në Punë, 5 (apo 63%) prej tyre i takojnë kategorisë së moshës 21 deri 30 vjeç, 2 (apo 29%) prej tyre i takojnë kategorisë së moshës 31 deri në 40 vjeç, ndërsa 1 (apo 8%) i takon kategorisë së moshës 41 deri në 50 vjeç.

GJINIA E KANDIDATËVE PJESËMARRËS NË TRAJNIM



◆ Gjinia

Nga 8 kandidatë përfitues të Trajnimit në Punë, 6 (apo 75%) prej tyre janë të gjinisë femërore, ndërsa 2 (apo 25%) janë të gjinisë mashkullore.

Statistika për kandidatët përfitues nga masa e Trajnimit në Punë


Statistika



◆ Etnia

Nga 8 kandidatë përfitues të Trajnimit në Punë, 6 (apo 75%) janë Shqiptar, 1 (apo 12.5%) është Egjiptian, 1 (apo 12.5%) është Romë.


Etnia e kandidatëve pjesëmarrës në trajnim



◆ Komuna

Nga 8 kandidatë përfitues të Trajnimit në Punë, 2 (apo 25 %) janë të komunës së Lipjanit, 1 (apo 12.5%) është i komunës së Fushë Kosovës, 1 (apo 12.5%) është i komunës së Vushtrrisë, 1 (apo 12.5%) është i komunës së Istogut, 1 (apo 12.5%) është i komunës së Prishtinës, 1 (apo 12.5%) është i komunës së Pejës dhe 1 (apo 12.5%) është i komunës së Prizrenit.

Komuna e kandidatëve pjesëmarrës në trajnim




Statistika për kandidatët përfitues nga masa e Trajnimit për Themelim Biznesi

Trajnimi për Themelim Biznesi është organizuar në kuadër të projektit SUREP nga Agjensioni i Përkrahjes së Punësimit Kosovë. Në trajnim kanë marrë pjesë Personat e Riatdhesuar të komunave target të projektit: Fushë Kosovë, Istog, Lipjan, Pejë, Prishtinë, Prizren dhe Vushtrri. Në kuadër të projektit SUREP, trajnimin për Themelim Biznesi e kanë përfunduar me sukses dhe janë certifikuar 59 Persona të Riatdhesuar. Trajnimi ka pasur për qëllim aftësimin e personave të riatdhesuar për të përpiluar Planin e tyre të Biznesit dhe për aplikimin për grant të mundësuar në kuadër të projektit SUREP.

Statistika




Mosha e kandidatëve pjesëmarrës në trajnim



◆ Moshë

Nga 59 kandidatë, të cilët kanë ndjekur Trajnimin për Themelim Biznesi, 23 prej tyre (apo 39%) i takojnë kategorisë së moshës 31 deri në 40 vjeç, 17 (apo 29%) prej tyre i takojnë kategorisë të moshës 41 deri në 50 vjeç, 13 (apo 22 %) prej tyre bëjnë pjesë në kategorinë e moshës 21 deri në 30 vjeç, 4 (apo 7%) prej tyre i takojnë kategorisë së moshës 51 deri në 65 vjeç, ndërsa vetëm 2 (apo 3%) i takojnë kategorisë së moshës nën 20 vjeç.

GJINIA E KANDIDATËVE PJESËMARRËS NË TRAJNIM



◆ Gjinia

Nga 59 kandidatë pjesëmarrës në trajnimin për Themelim Biznesi, 50 (apo 85%) prej tyre janë të gjinisë mashkullore, ndërsa 9 (apo 15%) janë të gjinisë femërore.


Statistika



◆ Etnia

Nga 59 kandidatë pjesëmarrës në trajnimin për Themelim Biznesi, 35 (apo 59%) janë Shqiptar, 9 (apo 15%) janë Ashkali, 8 (apo 14%) janë Egjyptian, 5 (apo 8%) janë Romë, 2 (apo 4%) janë Boshnjak.


Etnia e kandidatëve pjesëmarrës në trajnim



◆ Komuna

Nga 59 kandidatë pjesëmarrës në trajnimin për Themelim Biznesi, 12 (apo 20%) janë të komunës së Fushë Kosovës, 12 (apo 20%) janë të komunës së Lipjanit, 12 (apo 20%) janë të komunës së Vushtrrisë, 10 (apo 17%) janë të komunës së Istogut, 5 (apo 8%) janë të komunës së Prishtinës, 4 (apo 7%) janë të komunës së Pejës dhe 4 (apo 7%) janë të komunës së Prizrenit.

Komuna e kandidatëve pjesëmarrës në trajnim




Anketa me Personat e Riadhesuar pjesëmarrës në Trajnimin për Themelim Biznesi

Pas përfundimit të Trajnimeve për Themelim Biznesi, Ekipi i projektit SUREP ka realizuar anketën për vlerësim të Trajnimit nga ana e kandidatëve pjesëmarrës. Anketa është bërë përmes kontaktit në telefon. Nga 59 pjesëmarrës të Trajnimit, 50 prej tyre i janë përgjigjur pyetjeve të anketës, ndërsa 9 prej tyre nuk është arritur të kontaktohen për arsye të ndryshme.

◆ Të dhëna të përgjithshme

Në përgjithësi, të gjithë kandidatët e kanë vlerësuar shumë mirë Trajnimin për Themelim Biznesi, shkëlqyeshëm mënyrën e prezantimit të temave nga ana e trajnerit, shumë mirë ndikimin e trajnimit në rritjen e vetëbesimit për hapjen apo zgjerimin e biznesit, shkëlqyeshëm ndikimin e trajnimit në përpilimin e idesë së biznesit, shkëlqyeshëm kontributin e trajnimit në përpilimin e idesë së biznesit dhe shumë mirë progresin që të bëhen ndërmarrës apo ndërmarrëse pas trajnimit.

Përgjigjet e kandidatëve në pyetjet e anketës



Nga 50 kandidatët e anketuar, 49 prej tyre kanë thënë se do të ua rekomandonin miqve të tyre Trajnimin për Themelim Biznesi të mbajtur në kuadër të projektit SUREP dhe të organizuar nga Agjensioni i Përkrahjes së Punësimit Kosovë.



“Ka qenë një motiv për të rifilluar jetën prapë ne Kosovë përkundër moshës dhe kohës se gjatë të kaluar jashtë vendit”

Përfitues nga komponenta e riintegritit ekonomik, Komuna e Vushtrrisë

